



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.134/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, dega Besianë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, dega në Besianë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Besianë, kështu që Koalicionit LDK-AKR, dega në Podujevë, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 5,100.00 (pesëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes-pranimit të këtij vendimi, **nën kërcënim** të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paneli, me datën 07.06.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017, aktivisti i tyre ka vërejtur se mbi Rr. "Zahir Pajaziti" në Besianë është vendosur baneri i kandidatit për deputet Vezir Januzi nga koalicioni LDK-AKR. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se koalicioni LDK-AKR me vendosjen e me vendosjen e banerit të kandidatit të saj mbi rrugë publike ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4 par.1 pika (b), të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka prezantuar PZAP-it, një fotografi nga vendi ku është vendosur baneri i rastit në fjalë.

Koalicioni LDK-AKR, në përgjigje në ankesë të datës 08.06.2017, thekson se me të marrë urdhërin për masat e përmirësimit nga PZAP-i, lidhur me rastin Anr.134/2017, konsideron se kanë urdhëruar kandidatin dhe degën në Besianë që të ndërmarrë masa përmirësuese, mirëpo dega dhe kandidatit në Podujevë ka konfirmuar se për të vendosur flamujt e koalicionit zgjedhor LDK-AKR si dhe banerët e billbordët në vende dhe hapësira publike kanë marrë leje nga Kuvendi Komunal, Podujevë. Për të dëshmuar këtë, përgjigjes në ankesë u janë bashkangjitur edhe provat, kërkasen për shfrytëzimin e hapësirës publike si dhe konfirmimin nga komuna Podujevës. Me propozim për PZAP-in, që mos të ju shqiptojë dënlime subjektit të tyre politik sepse nuk ka pasur shkelje ligjore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndes në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, te cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se baneri i kandidatit të koalicionit LDK-AKR, Vezir Januzi është vendosur mbi Rr. Zahir Pajaziti në Besianë, e cila çështje nuk është mohuar as nga përgjiga në ankesë e Koalicionit PDK-AAK-NISMA.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se koalicioni i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjeket politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike*”

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vndimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti baneri i kandidatit të tyre është i vendosur mbi rrugë publike, gjegjësisht mbi Rr. ”Zahir Pajaziti”, Besianë, po ashtu e njëjta shkelje nga ky koalicion është përsëritur disa herë në këto zgjedhje.

Me rastin e vendosjes paneli mori parasysh edhe pretendimet e koalicionit të theksuar me lart, që theksohet se Kuvendi Komunal në Besianë i ka lejuar për shfrytëzim pronat publike, këto pretendime paneli i vlerëson si të paqendrushme dhe pa asnjë bazë ligjore sepse vendosja e banerit mbi rrugë publike është në kundërshtim me nenin 33.b e LZP-së, mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë ka ka bërë shkelje të kundërligjshme të parapara në ligjin e sipërcituar më lartë.

Paneli poashtu vlerësoi me rastin e vendosjes, lidhur me gjobën e shqiptuar si në dispozitivë të këtij vendimi, se koalicioni LDK-AKR, nuk ka bërë asnjë veprim për ta përmirësuar shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike respektivisht largimin e banerit të

kandidatit të tyre të vodosur mbi rrugë publike edhe pse është urdhëruar nga PZAP-i, me parashtresën e datës 07.06.2017 që ta përmison shkeljen e theksuar më lartë.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 3 par.2 të Rregullës Nr.01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.134/2017 më datën 09.06.2017.



Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rafet Haxhaj", written over the circular stamp.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.*